



BALLINA

LAJME ▾

VIDEO

BOTA

SPORT ▾

OPINION ▾

SHOWBIZ ▾

LIFESTYLE ▾

AUTO & TEK ▾

FUN ▾

ENGLISH ▾

Kosovarët vazhdojnë të mos festojnë pa armë, raportohen katër raste të gjuajtjes me armë në ahengje



29/07/2024 09:05



Ahengjet në Kosovë siç duket vazhdojnë të zhvillohen si dikur, me gjuajtje të armëve.

Kjo "Traditë" e cila shpesh herë ka bërë që të lëndohen persona të ndryshëm, po vazhdon edhe sot.

Pavarësisht thirrjeve të shumta të Policisë së Kosovës për të mos gjuajtur me armë, katër raste janë raportuar së fundi vetë në rajonin e Gjakovës dhe Gjilanit.

Nga këto të shtëna me armë ka pasur edhe persona të lënduar.

Njoftimi nga Policia:

ARMËMBAJTJE PA LEJE


- **Rr. Ardhmëria, Gjakovë 28.07.2024-23:00.** Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar, pasi që i njëjti gjatë një ahengu familjar ka shtënë me armë zjarri. Nga i dyshuari është konfiskuar arma e zjarrit e llojit Valtro dhe katër gëzhoja. Pas intervistimit, me vendim të prokurorit i dyshuari lirohet në procedurë të rregullt.
- **Skivjan, Gjakovë 28.07.2024-23:50.** Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar, pasi që i njëjti gjatë një ahengu familjar ka shtënë me armë zjarri. Nga i dyshuari është konfiskuar arma e zjarrit e llojit Blow dhe gjashtë gëzhoja. Pas intervistimit, me vendim të prokurorit i dyshuari lirohet në procedurë të rregullt.

SHKAKTIM I RREZIKUT TË PËRGJITHSHËM

- **Rogoqicë, Kamenicë 28.07.2024-11:30.** Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar, pasi që i njëjti në një aheng familjar ka shtënë me armë zjarri. Si pasoj e të shtënave viktima mashkull kosovar ka pësuar lëndime trupore në këmbë dhe i njëjti është dërguar për tretman mjekësor. Në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe konfiskuar disa gëzhoja, ndërsa nga i dyshuari janë konfiskuar dy armë zjarri. Me vendim të prokurorit, pas intervistimit i dyshuari dërgohet në mbajtje.
- **Rr. Mulla Idrizi, Gjilan 28.07.2024-17:30.** Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar, pasi që i njëjti në një aheng familjar ka shtënë me armë zjarri. Në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe konfiskuar 11 gëzhoja, ndërsa nga i dyshuari kane konfiskuar armën e zjarrit Eklol e kalibrit 9 mm. Me vendim të prokurorit, pas intervistimit i dyshuari dërgohet në mbajtje./Lajmi.net/

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LugnetMedia



Artikuj të ngjashëm



July 29, 2024

ARKEP: Kosova ka afër 2 milionë përdorues të telefonisë mobile



July 29, 2024

Gjuajtji me armë në aheng familjar në Kamenicë, lëndon këmbën dhe...




July 29, 2024

Arrestohet një person- Ndezi një zjarr që pastaj doli jashtë kontrollit...



July 29, 2024

Gjendja e kolonave tek pikat kufitare në hyrje të Kosovës



July 29, 2024

Aksident i rëndë trafiku në Suharekë, vdes një këmbësore



July 29, 2024

Sot shpallet aktgjyrimi kundër Krivaqës e Sejdiut

lajmi.net

info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information

RRJETET SOCIALE

